



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.419/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit NTSH “Zh...”, në Çagllavicë, kundër debitorit “D...” SH.P.K., me adresë Zona Industriale Suharekë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, PP.nr.217/2019 të datës 14.01.2021, me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit NTSH “Zh...”, me adresë magjistratja Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, PP.nr.217/2019 i datës 14.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me aktvendimin e ankimuar, PP.nr.217/2019 të datës 14.01.2021, në pikën I të dispozitivit ka hedhur poshtë propozimin për ekzekutim të palës kreditore NTSH “Zh...” me numër fiskal .... dhe numër biznesi ....., në Çagllavicë, ndaj debitorit “D...” SH.P.K., me numër fiskal .... dhe numër biznesi ....., për shumën e borxhit prej 1.582.36 Euro, të mbështetur mbi bazën e dokumentit të besueshëm – faturës nr.740, datë 16.11.2017. Në pikën II të dispozitivit shpenzimet procedurale lidhur me harxhimet e krijuara për zhvillimin e procedurës përmbartimore i bartë pala kreditore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (pretendime të kuptuara nga referati i ankesës), me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që urdhri përmbartimor P.nr.825/2019 i datës 09.12.2019 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori kreditorit NTSH “Zh...”, në Çagllavicë, me datë 09.12.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit “D...” SH.P.K., në Suharekë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.740 të datës 16.11.2017, për shumën e detyrimit prej 1,582.36 Euro.

Përmbartuesi privat Fadil I. Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.825/2019 të datës 09.12.2019, ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se fatura e lëshuar nga kreditori i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datë 18.12.2019, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me propozim që i njëjti të hedhet poshtë si të pabazuar dhe paargumentuar. Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 20.12.2019, me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor P.nr.825/2019 i datës 09.12.2019 të vërtetohet.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të propozimit për përmbartim dhe dokumentit të besueshëm – faturës nr.740 të datës 16.11.2017 në bazë të së cilës është paraqitur propozimi për përmbartim ka gjetur se e njëjta është kopje, për këtë me aktvendimin PP.nr.217/2019 të datës 30.11.2020, ka obliguar kreditorin që në afat prej 3 ditësh, pas pranimit të aktvendimit, t’ia prezantoj gjykatës dokumentin origjinal ose kopje të vërtetuar pran organit kompetent/noterisë, dokumentin e besueshëm faturën nr.740 të datës 16.11.2017. Kreditori me parashtrësën e datës 13.01.2021 ka njoftuar gjykatën se fatura nr.740 e datës 16.11.2017 e lëshuar për debitorin është dorëzuar tek debitori dhe është nënshkruar nga debitori, fatura e njëjtë është fotokopjuara dhe nënshkruar nga debitori për kreditorin. Fatura e nënshkruar me nënshkrim origjinal të debitorit dhe e nënshkruar dhe vulosur me kopje nga debitori është dorëzuar si dëshmi për procesim në përmbartim.

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe parashtrësës së dorëzuar nga kreditori, ka nxjerrë aktvendimin PP.nr.217/2019 të datës 14.01.2021 me të cilin ka hedhur poshtë propozimin për ekzekutim të palës kreditore, me arsyetimin se fatura e cila i është bashkangjitur parashtrësës së datës 13.01.2021, nuk korrespondon me kërkesën e nenit 37 të LPP, gjegjësisht dërgimi i saj nuk është në origjinal, por as në kopje të vërtetuar sipas ligjit, me konkretisht fatura në kopje mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbartimore, me faturën e dërguar nëpërmjet parashtrësës së datës 13.01.2021, nuk është në harmoni, ngase fatura që është në kopje është e nënshkruar nga debitori ndërsa fatura që është e dorëzuar në origjinal është pa nënshkrimin e debitorit. Tutje gjykata ka arsyetuar se meqenëse pala kreditore nuk ka vepruar konform aktvendimit P.nr.217/2019 të datës 30.11.2020, atëherë mbi bazën e parimit *conditio sine qua non*, ka vendosur që propozimi për

përmbarrim të hedhet poshtë në kuptim të nenit 102 paragrafi 3 të LPK-së, pasi që dorëzimi i dokumenti të besueshëm nuk rezulton me dokumentin që është bazë juridike e kësaj procedurës.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Me dispozitën e nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, përcakton se: *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”,* e që në rastin konkret propozimi i kreditorit nuk i ka përmbushur kushtet për përmbarrim.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e nenit 38 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”,* me aktvendimin PP.nr.217/2019 të datës 30.11.2020, ka ftuar kreditorin që në afat prej 3 ditësh ti prezantoj gjykatës dokumentin e besueshëm faturën nr.740 të datës 16.11.2017, në origjinal apo kopje të vërtetuar sipas ligjit, e që në rastin konkret fatura kopje e prezantuar nga kreditori me parashtrësën e datës 13.01.2021, në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, nuk përfaqëson dokument të besueshëm. Andaj përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë mbi hedhjen poshtë të propozimit për përmbarrim është i drejtë dhe i ligjshëm e të cilin qëndrim e përkrahë edhe kjo gjykatë.

Duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka hedhur poshtë propozimin e kreditorit.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë  
K.DH.SH.II.nr.419/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri